

URDHËR
Nr.250, datë 2.6.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT “MENAXHIM-BIZNESI” DHE FILLIMIN
E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTË PROGRAM, PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE JOPUBLIKE, “UNIVERSITETI “KRISTAL””, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Administrimit të Biznesit të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programin e ri të studimit të ciklit të parë, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

i) Menaxhim-biznesi.

2. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr.125, datë 3.12.2010 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë universitare jopublike, “Universiteti “Kristal””, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj